



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:056680

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06374933

**C.nr.826/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.G. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson S.M.N. kundër të paditurës M.Sh., K.Sh.P. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, në ndërtesën ish – Rilindja, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 1,569.48, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 30.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar** kërkesëpadia e paditësit H.G. nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura, M.Sh., K.Sh.P. me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1,569.48 € (një mijë e pesëqind gjashtëdhjetë e nëntë euro, e dyzetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 03.03.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **134.00 € (njëqind e tridhjetë e katër)**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi H.G. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij S.M.N. avokate nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datë 03.03.2023, ka parashtruar padi, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 20.05.2024, kundër të paditurës M.Sh., K.Sh.P. me seli në Prishtinë, të

cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 1,569.48 €.

E autorizuar e paditësit në padi ka theksuar se paditësi në bazë të vendimit të datës 29.04.2021, pensionohet sipas ligjit me rastin e arritjes së moshës së pensionimit. Paditësi i është drejtuar punëdhënësit për kompensimin e tri pagave përcjellëse dhe jubilarë, sipas Kontratës Kolektive Sektoriale, të shëndetësisë ku punëdhënësi i fundit duhet ti kompensoi punëtorëve me rastin e pensionimit tre paga përcjellëse për çdo 10 vite nga një page bazë në emër të pagës jubilarë. Inspektorati i Punës në Prizren paditësit i ka aprovuar ankesën me numër 3202/2021, për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit. Meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paditësi nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme të ankimit. Kontrata Kolektive Sektoriale ka qenë në fuqi në periudhën kohore tre vjeçare, nga data 11.06.2018, deri me datën 10.06.2021. Tutje ka shtuar se kërkesëpadia e paditësit është në kundërshtim me Kontratën Kolektive Sektoriale, respektivisht në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 3, pika 3.1, 3.2 dhe 3.3. Andaj, në fund ka kërkuar nga gjykata që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik IKSHPK.

Nga vërtetimi i datës 29.04.2021, të lëshuar nga Zyra Rajonale e Pensioneve në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësit H.G. me numër personal .... i është njohur e drejta e pensionit bazik të moshës.

Nga shkresa me numër 120/24, të datës 14.05.2024, të lëshuar nga drejtori i QRSHP në Prizren dhe listat e pagave me numër EM00061392, të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi H.G. në janar, shkurt dhe mars 2021, ka marrë pagë neto në lartësi prej 523.16 euro dhe se i njëjti ka gjithsej 32 vite përvojë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që*

*konfirmohet apo caktohet në të*". Andaj vërtetimit të datës 24.09.2021, të lëshuar nga Zyra Rajonale e Pensioneve në Prizren, shkresës me numër 120/24 dhe listave të pagës me numër EM00061392, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me përvojën e punës, konkretisht paditësi H.G. nga Prizreni i ka 32 vite përvojë pune në Institucionet Shëndetësore dhe i njëjti tri pagat e fundit mujore i ka marrë në lartësi prej 523.16 euro.

Sipas nenit 4 par. 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (LP), në mënyrë decisive përcaktohet se *"Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj"*. Po ashtu, në nenin 90 par. 5 të LP-së, theksohet që *"Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive"*. Pastaj, në bazë të nenit 78 të LP-së, parashihet e drejta e të punësuarit që të kërkoj nga punëdhënësi për realizim të ndonjë të drejte dhe punëdhënësi është i obliguar që të vendos lidhur me një kërkesë të tillë. Në vazhdim, me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet e drejta e të punësuarit që të kërkoj mbrojtje gjyqësore në Gjykatë Kompetente lidhur me vendimin apo mos veprimin e punëdhënësit lidhur me ndonjë kërkesë së të punësuarit.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të datës 12.06.2018, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 12.06.2018.

Me nenin 17 par.3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të dt.12.06.2018, është paraparë se *"Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: "për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të tre paga mujore të tij"*. Si dhe duke u bazuar në Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, në pikë V, përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që *"punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit"*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *"Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij."* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që

vlerësoi se në rastin konkret e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtorë në institucionin shëndetësor, t'ia paguaj kompensimin për shpërblimin jubilar, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, të dt.12.06.2018, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht lidhur me shpërblimin jubilar për paditësin H.G. në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1,569.48 euro. Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 17 par 3, nën par.3.3, të kontratës së lartcekur, pasi që për të njëjtin kërkesa për kompensimin e shpërblimit jubilar është bërë e arritshme, konkretisht për 30 vite përvojë pune, tri rroga mujore.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (03.03.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqjësë dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 134.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.826/2023, datë 30.10.2024**

**G j y q t a r i**

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.